

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SEKTORI I KOORDINIMIT NDËRKOMBËTAR PROJEKTEVE DHE KËRKIMIT
SHKENCOR



Finanziato
dall'Unione europea
NextGenerationEU



Ministero
dell'Università
e della Ricerca



Italiadomani



UNIVERSITÀ
DEL MOLISE

Nr. 2025/Prot.

Gjirokastrë, më 19.12.2025

MIRATOI
REKTORI

Prof. dr. Jaho **CANA**

Lënda: Thirrje për aplikime për bursë mobiliteti për mësimdhënie për stafin e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm" në kuadër të Programit Erasmus+

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, në bashkëpunim me Universitetin e Molises, në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1, fton personelin akademik të punësuar në UGJ, të aplikojë për të përfutur një bursë për mësimdhënie/trajnim për një periudhë prej 5 ditësh në Universitetin e Molises.

Mobiliteti në këtë institucionin pritët të përmbushet brenda periudhës janar - shkurt të vitit akademik 2025 - 2026.

Shpenzimet do të mbulohen nga Universiteti pritës në kuadër të programit Erasmus+.

Numri i bursave për mësimdhënie – 1 (një).

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

- të jenë staf efektiv i UGJ-së;
- t'i përkasin fushës së turizmit;
- të kenë përvojë akademike dhe shkencore në fushën e sipërpërmendur;
- të argumentojnë qartazi qëllimin e vizitës në institucionin pritës.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Titulli/ grada shkencore;
- Njohja e gjuhës së huaj sipas nivelit të përcaktuar në marrëveshjen ndërinstitucionale;
- Prioritet i jepet stafit që nuk ka patur më parë eksperiencë mobiliteti;

Kritere të tjera shtesë përfshijnë:

- Plani i mobilitetit i propozuar

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Formular aplikimi;
- Kopje të pasaportës;
- Vërtetim punësimi;
- CV në gjuhën angleze;
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohjen e gjuhës angleze/italiane. Bën përjashtim stafi i cili zotëron një diplomë univeristare në gjuhën angleze/italiane.
- Plani i mobilitetit (Mobility Agreement) në gjuhën angleze lidhur me qëllimin dhe përfitimin institucional të mobilitetit, bazuar në prioritetet e nënvizuara sipas udhëzimeve të Komisionit Evropian për këtë skemë.

(<https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/organisations#tab-1-1>).

Për përzgjedhjen e kandidatëve ngrihet nga Rektori një komision *ad hoc* i cili vlerëson dosjet e aplikantëve.

Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor në format fizik dhe elektronik brenda datës 30.12.2025 ora 16:00.

Kandidatët fitues do të njoftohen prej Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor brenda datës 07.01.2026 ora 16:00 në adresën zyrtare të e-mail-it.

Kandidatët aplikues kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të komisionit *ad hoc* pranë Rektorit brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit.

Procesi i brendshëm i përzgjedhjes nuk garanton që mobiliteti do të kryhet. Përzgjedhja duhet të konfirmohet nga institucioni pritës përmes një letre pranimi/ftese.

Për të dhëna të mëtejshme mund të kontaktoni me Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër ju uron suksese!

Zv/Rektore për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj



Konceptoi: Irma Gjollëshi

